

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK
DHE SIGURINË KIBERNETIKE**

Nr.Prot. 12/2
Datë 27/01 2021

**QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

Nr.Prot. 14
Datë 27/01 2021

**AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Nr.Prot. 27/2
Datë 27/01 2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE
SIGURINË KIBERNETIKE**

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

DHE

QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Sot, më datë 27 / 01 / 2021, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (në vijim referuar si AKCESK), me adresë “Rruga Papa Gjon Pali II”, Kati i parë, Nr. 3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Znj. Vilma Tomço,

Autoriteti i Mediave Audiovizive (në vijim referuar si AMA), autoriteti mbikëqyrës i veprimtarive audiovizive në Republikën e Shqipërisë, me adresë “Rruga Papa Gjon Pali II” Nr. 15, KP 1010, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i tij, Z. Gentian Sala,

dhe

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (në vijim Qendra CVE), me adresë “Rruga Papa Gjon Pali II”, KATI i dytë, Nr.3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Znj. Lejdi Dervishi.

Palët e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi në frymën e ndërveprimit institucional, bien dakord se, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të ofrimit të ekspertizës, mbështetjes operacionale dhe teknike në fushën e sigurisë kibernetike, ndaj palët kanë vendosur të konkludojnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është krijimi i kushteve të mjaftueshme të aksesit institucional, si dhe detajimi i veprimeve proceduriale me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet palëve, për mbrojtjen e individëve me fokus të veçantë të fëmijëve dhe të rinjve, nga përmbajtje të paligjshme dhe të dëmshme në internet dhe sigurinë online të tyre.

Neni 2 Baza ligjore

Palët do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet që do të ndërmarrin, brenda kompetencave dhe tagrave të dhëna prej legjislacionit të posaçëm që rregullon veprimtarinë e tyre si më poshtë:

- a. Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit, Nr. 930, datë 18.11.2015.
- b. Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
- c. Ligji Nr.2/2017 “Për sigurinë kibernetike”
- d. Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

Neni 3 Fushat e bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë duke shkëmbyer ekspertizë dhe praktikat më të mira në fushën e sigurisë kibernetike, në veçanti në fushat e mëposhtme:

- a. Rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues për mbrojtjen e përdoruesve nën 18 vjeç në Internet.
- b. Zhvillimi i politikave të reja për përmirësimin e kuadrit rregullator të agjencive ligj zbatuese.
- c. Përmirësimi i mekanizmave për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme në Internet.
- d. Zhvillimi i një fushate kombëtare komunikimi lidhur me edukimin mbi sigurinë online për fëmijët dhe komunitetin, si edhe edukimin kundër çdo lloj forme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, si dhe edukimin dixhital të komunitetit.
- e. Bashkëpunim teknik sipas fushave të përcaktuara në këtë marrëveshje.
- f. Trajnime të lidhura me qëllimin dhe fushën mbi të cilën do të ketë efekt kjo marrëveshje.
- g. Koordinim institucional për zgjidhje efikase të problematikave të evidentuara si fusha veprimi në këtë marrëveshje.
- h. Bashkëpunim në fusha të tjera të identifikuar si të rëndësishme reciprokisht.

Neni 4

Mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit

- 4.1 Palët bien dakord, të shkëmbejnë informacionet e mbledhura dhe të përpunuara, statistikat, analiza dhe raporte, në përputhje me aktet e tyre ligjore e nënligjore. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” nuk është objekt dhe është jashtë fushëveprimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.
- 4.2 Secila palë brenda një afati 10 (dhjetë) ditor do t’i vendosë në dispozicion, palëve të tjera, informacionin e kërkuar, apo informacionin mbi gjetjet e kryera, bazuar në përcaktimet e kësaj Marrëveshje.
- 4.3 Palët marrin përsipër të respektojnë parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, mbrojtjes së interesit publik dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- 4.4 Palët bien dakord, të bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit mbi gjetjet apo raportimet që rezultojnë nga monitorimi i ngjarjeve kibernetike, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në nivel Kombëtar.
- 4.5 Shkëmbimi i informacionit mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në:
 - a. Vëzhgimet dhe gjetjet e përgjithshme që rezultojnë nga aktiviteti i njëjës Palë, që mund t’i shërbejnë punës së Palës tjetër;
 - b. Shkëmbimi i praktikave, mjeteve dhe rekomandimeve më të mira, që mund t’u ndihmojnë palëve për të forcuar bashkëpunimin e tyre në fushat që mbulohen nga Marrëveshja e Bashkëpunimit.

Neni 5

Roli dhe përgjegjësitë e palëve

- 5.1 Palët marrin përsipër të ofrojnë:

- a. Bashkëpunim, duke identifikuar dhe vepruar në fushat me interes të përbashkët dhe kërkime të përbashkëta.
- b. Bashkëpunim, gjatë përgatitjes së dokumenteve strategjike, të tilla si strategjitë dhe planet e veprimit në fushat e bashkëpunimit të identifikuara në këtë Marrëveshje.
- c. Bashkëpunim në çështjet administrative, duke ndarë përvojën, ekspertizën dhe praktikatat më të mira, duke përfshirë fushën e menaxhimit të cilësisë dhe riskut të sigurisë kibernetike.

5.2 Pjesëmarrje në aktivitete dhe veprimtari të organizuara nga secila palë dhe që përfshihet në fushat e bashkëpunimit.

Neni 6

Konfidencialiteti dhe siguria

- 6.1 Secila Palë merr përsipër të ruajë konfidencialitetin e çdo informacioni, dokumenti ose materiali tjetër të ofruar nga Pala tjetër, të mos e ndajë atë me palë të treta pa pëlqimin paraprak me shkrim të asaj Pale dhe të mos përdorë informacionet për qëllime të tjera jashtë zbatimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.
- 6.2 Secila Palë do të sigurojë që informacioni i ofruar ose shkëmbyer, sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, të jetë i mbrojtur sipas rregullave të sigurisë dhe parimeve përkatëse.
- 6.3 Pala që është përgjegjëse për dhënien e informacionit mund të tregojë, në momentin e sigurimit të informacionit, çdo kufizim në aksesin ose përdorimin e tij, në kushte të përgjithshme ose specifike, duke përfshirë transferimin ose fshirjen e tij.
- 6.4 Palët bien dakord të bashkëpunojnë, sipas rastit, në fushën e sigurisë, veçanërisht në lidhje me masat e nevojshme për mbrojtjen e informacionit sensitiv, nëpërmjet konsultimit, mbështetjes së ndërsjellë ose shkëmbimit të praktikave më të mira.

Neni 7

Komunikimi i palëve

- 7.1 Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre në formë shkresore dhe/ose me e-mail zyrtar.
- 7.2 Palët do të caktojnë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme, pikat e kontaktit të përshtatshme për zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 8

Ndryshimet, shtesat, modifikimet e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

- 8.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet ose plotësohet në çdo kohë me pëlqim të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

8.2 Ato do të hyjnë në fuqi me Nënshkrimin e palëve pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje.

Neni 9 Dispozita të fundit

9.1 Secila nga Palët mund të ndërpresë angazhimin e saj sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, duke i dhënë njoftim me shkrim një muaj para Palës tjetër.

9.2 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, do të mbetet në fuqi ndërmjet Palëve deri në një kohë kur ata të dorëzojnë njoftimin e tyre me shkrim për përfundimin e saj në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 10 Hyrja në fuqi

10.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të jetë e vlefshme për një afat të pacaktuar.

10.2 Nënshkruar në Tiranë, më 27/01/2021, në tre kopje origjinale, nga një për secilën palë, në gjuhën shqipe.

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK
DHE SIGURINË KIBERNETIKE
(AKCESK)**

**QENDRA E KOORDINIMIT
KUNDER EKSTREMIZMIT TE
DHUNSEM**


DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Znj. VILMA TOMÇO



DREJTOR

Znj. LEJDI DERVISHI



**AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

KRYETAR

Z. GENTIAN SALA

